

VENDIM
Nr.140, datë 10.11.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.3, DATË
16.9.2009 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- I. Deputeti Ditmir Bushati caktohet Kryetar në Komisionin për Integrimin European.
- II. Deputeti Marko Bello largohet nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe caktohet anëtar në Komisionin për Integrimin European.
- III. Deputetja Paulina Hoxha caktohet anëtare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)